Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0003

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Pro & Co Group" SH.P.K., dhe OE NPN "EUROING" SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të "MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren" me numër të prokurimit 207-23-10441-5-1-1, me 15/04/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohen**, si pjesërisht të bazuara ankesat e OE "Pro & Co Group" SH.P.K., me nr. 2024/0003 e datës 03/01/2024, dhe ankesa OE NPN "EUROING" SH.P.K. me nr. 2024/0009, e datës 04/01/2024, kurse vendimi i AK "MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren" me numër të prokurimit 207-23-10441-5-1-1, mbetet në fuqi

2. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.09.2023, “MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren” me numër të prokurimit 207-23-10441-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 625,000.00 €.

Me 22.12.2023 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë “HARST Group" SH.P.K.

Me 27.12.2023, OE “Pro & Co Group” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 25.12.2023 po ashtu edhe OE NPN “EUROING” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 27.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 03.01.2024, OE “Pro & Co Group” SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0003/2024 ndërsa me datë 04.01.2025 OE NPN “EUROING” SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0009/2024.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesat i përmbajnë elementet e parapara me nenin 111 të LPP dhe janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP, pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP. Meqë ankuesit ka statusin e palës së interesuar sipas nenit 4 paragrafi 1, nën-paragrafi 26 të LPP, kurse ankesat janë ushtruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër, të njëjtat bijën nën kompetencat e këtij Organi përkitazi me shqyrtimin dhe vendosjen në mënyrë meritore, në kuptim të nenit 105 të LPP.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me

këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 01/24 dhe ankesa nr. 14/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me Nr.2024/0003 dhe Nr.2024/0009 ndërsa me datë 15.01.2024, janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 2024/0003 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 2024/0009 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës nr. 2024/0003 e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku operatori ekonomik nuk është deklaruar fare për pajtim apo mos pajtim me raportin e ekspertizës, ndërsa Autoriteti Kontraktues është deklaruar se nuk pajtohet mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, duke e shprehur mos pajtimin e tij si në vijim:

"Përmes këtij dokumenti ju njoftojmë se nuk pajtohemi me ekspertizat e paraqitura nga Eksperti: Enver Bytyqi, lidhur me lenden: Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren me numër: 207-23-10441-5-1-1 konkretisht nuk pajtohemi me ekspertizën: 003/2024:

Konstatimin nr.1 të ekspertit shqyrtues e kundërshtojmë duke u bazuar që në kërkesat e DT ka qenë si kërkesë projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna, në rastin konkret ky GOE ka prezantuar disa referenca/procesverbale për rregullimin e fushave sportive e terreneve sportive, mirëpo nuk ka prezantuar asnjë referencë që ka kryer stadium ose ndonjë Sallë Sportive që përfshijnë tribuna, ashtu siç ka qenë kërkesa në DT.

Ne mirëkuptojmë arsyetimin e ekspertit shqyrtues që ndonjë punë e kryer nga ky GOE është e ngjashme, mirëpo bazuar në LPP-në kërkesa në DT duhet të përfillen për të gjithë OE, dhe nuk kem drejtë pas hapjes së ofertave të mos i zbatojmë kërkesat e vendosura në DT apo të zbatojmë kritere tjera ashtu siç konstaton eksperti shqyrtues duke pasur parasysh që kërkesa ka qenë e qartë të dëshmohen referenca të objekteve sportive dhe stadiume ose salla sportive me tribuna, dhe në rast të paqartësive kane mundur OE në kohen e sqarimeve të kërkohen sqarime.

Konstatimin nr.2 të ekspertit shqyrtues e kundërshtojmë duke u bazuar që eksperti shqyrtues është munduar që këtë pretendim të konsideroj të bazuar duke u përmendur vetëm një pjesë të nenit 26 paragrafin 5 të nenit 26 të RrPP 001/2022, duke e anashkaluar pikat tjera të nenit 26 siq është neni 26.6 citoj:

Neni 26 RrPP 001/2022

26.6 Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për

sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse

Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë. Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit. Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara.

Ky konstatim është plotësisht i pabazuar pasi që eksperti shqyrtues nuk ka trajtuar pretendimet sipas neneve përkatëse si neni 70 i LPP-së dhe neni 26.6 I RrPP 001/2022 mirëpo është munduar të arsyetoj me nene dhe paragrafë që nuk janë adekuate dhe të specifikuar për kërkesën e ISO standardeve.

Gjithashtu ky konstatim është i pabazuar edhe për faktin që GOE ka formuar marrëveshje me anëtarë tjerë për kryerjen e punimeve duke ndarë përgjegjësit, dhe ne në DT kemi kërkuar që ofertuesi duhet të jetë I certifikuar me disa ISO standarde. Në rastin konkret nëse nuk kane të prezantuar të gjithë anëtaret e grupit standardet, I bie që disa punime që janë përgjegjësi e anëtareve të pa standardizuar do të kryhen në mënyrë jo cilësore dhe nga kompani që nuk është e standardizuar më standardet e kërkuar. Andaj konsiderojmë që më të drejtë është eliminuar pasi që anëtarët e grupit të cilët nuk janë të standardizuar me ISO të kërkuar rrezikojnë cilësinë dhe profesionalizimin e punimeve që do të kryhen në këtë projekt, pasi që projekti është një konstruksion komplet nga Metali, kërkon një kompani profesionale, që kanë përvojë në punime të tilla dhe që janë të standardizuara për ato punime.

Duke besuar në drejtësinë e Panelin Shqyrtues, mirëpresim të merrni për bazë kundërshtimin tonë, të cilin mendojmë që e kemi të bazuar, dhe mendojmë që Eksperti Shqyrtues nuk i ka trajtuar në mënyrë meritore pretendimet e OE ankues, duke dashur të aprovoj si të bazuar pretendimet është referuar neneve dhe paragrafëve jo adekuate të LPP-së dhe Rregullores 001/2022 për çështjet në fjalë.

Në këtë formë kërkojmë nga ana e Panelit Shqyrtues të refuzoi ankesën e kompanisë PRO & CO konkretisht të refuzoi ankesën 003/2023 dhe të lënë ne fuqi Vendimin e Autoritetit Kontraktues te datës: 22.12.2023.

Raportin e ekspertizës nr. 2024/0009 e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku operatori ekonomik është pajtuar me raportin e ekspertizës, ndërsa Autoriteti Kontraktues është deklaruar se nuk pajtohet mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, duke e shprehur mos pajtimin e tij si në vijim:

"Përmes këtij dokumenti ju njoftojmë se nuk pajtohemi me ekspertizat e paraqitura nga Eksperti: Enver Bytyqi, lidhur me lenden: Ndërtimi i fushave të tenisit – Qendra Sportive në Prizren me

numër: 207-23-10441-5-1-1 konkretisht nuk pajtohemi me ekspertizën: 009/2024 pasi qe:

Konstatimin nr.1 të ekspertit shqyrtues e kundërshtojmë duke u bazuar që në kërkesat e DT ka qenë si kërkesë projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna, në rastin konkret ky GOE ka prezantuar disa referenca/procesverbale për rregullimin e fushave sportive e terreneve sportive, mirëpo nuk ka prezantuar asnjë referencë që ka kryer stadium ose ndonjë Sallë Sportive që përfshijnë tribuna, ashtu siç ka qenë kërkesa në DT. Ne mirëkuptojmë arsyetimin e ekspertit shqyrtues që ndonjë punë e kryer nga ky GOE është e ngjashme, mirëpo bazuar në LPP-në kërkesa në DT duhet të përfillen për të gjithë OE, dhe nuk kem drejtë pas hapjes së ofertave të mos i zbatojmë kërkesat e vendosura në DT apo të zbatojmë kritere tjera ashtu siç konstaton eksperti shqyrtues duke pasur parasysh që kërkesa ka qenë e qartë të dëshmohen referenca të objekteve sportive dhe stadiume ose salla sportive me tribuna, dhe në rast të paqartësive kane mundur OE në kohen e sqarimeve të kërkohen sqarime.

Konstatimi 2. të eksperti shqyrtues, e plotësojmë deklaratën e tij: Ky Operator Ekonomik, ka kërkuar qasje ne dokumente zyrtare te premten pas përfundimit te orarit zyrtar, dhe ka paraqitur një Kërkesë për Rishqyrtim ende pa u kthyer ne pune si te tilla AK nuk ka pasur mundësi t'i jap dokumentacion (është e paraqitur edhe ne Vendimin e AK-se) se kjo kërkesë është paraqitur ende pa i ofruar qasje ne dokumente zyrtare kompanisë. Me pranimin e dokumentacionit për qasje ne dokumente zyrtare, si Zyre i kemi ofruar qasje ne dokumentacionin e pastruar (Ashtu siç është e rregulluar edhe me Ligj kjo çështje) dhe ne këtë forme kompania EuroING ka paraqitur edhe pretendimin e trete se sikur mos t'i kishte dokumentacionin nuk do te mund t'a pretendonte lidhur me aspektin e çmimit te metalit.

Konstatimi 3. të ekspertit shqyrtues, e pranojmë ne plotni këtë pretendim pasi qe i njëjti ketë pretendim nuk e ka ngritur fare në kërkesë për rishqyrtim, po ashtu edhe nëse do të trajtohej është i pabazuar (pasi qe në këtë procedurë nuk kemi te bëjmë me produkte me çmim njësi por me çmimin e përgjithshëm) dhe se OE ka kompetencë të vendosë aspektin e çmimeve.

Në këtë formë kërkojmë nga ana e Panelit Shqyrtues të refuzoi ankesën e kompanisë EUROIING konkretisht të refuzoi ankesën 009/2023 dhe të lënë ne fuqi Vendimin e Autoritetit Kontraktues te datës: 22.12.2023.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në ketë rast Paneli mori paraprakisht konstatoi se AK ka zbatuar:

a. procedurë të hapur, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.37. të nenit 4, të LPP;

b. lloji i kontratës: Punë, sikurse parashihet me paragrafin 3, të nenit 27, të LPP;

c. vlera e parashikuar e kontratës: 527,022.50€ vlere e madhe, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.28 të nenit 4, lidhur me paragrafin 1, të nenit 19, të LPP

d. Kriteri i dhënies së kontratë është çmimi ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas peshës së kritereve të përshkruara në Aneksin 6 të dosjes së tenderit.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Paneli shqyrtues (në përbërje kolegjiale) administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

Pohimet ankimore te Ankuesit "Pro & Co Group Sh.P.K.

Ankuesi atakon vendimin e AK lidhur me eliminim e tij/saj ku sipas AK, operatori ekonomik në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550.000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të obiekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna),ju si Operator Ekonomik nuk keni paraqitur asnjë objekt sportiv. stadiume apo salla sportive te cilat përfshinë tribuna. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues sipas opinionit të dhënë nga KRPP termi "e ngjashme" nuk do të thotë se natyra e kontratës të jetë identike apo e njëjtë me përshkrimin e objekteve të dhëna në DT. Kontrata të ngjashme sipas përshkrimit të termit "ngjashme" të dhënë sipas opinionit të KRPP mjafton të jetë projekt objekt ndërtimor sportiv, ku mund të përfshihen edhe kategorizimi i kontratave të objekteve të ndërtimit të lartë. OE ankues ka ofruar listën e kontratave të ngjashme të dëshmuara sipas kërkesës së DT dhe ka arritur vlerën e kërkuar nga AK në DT (shënim: pas verifikimit te kontratave ne sistemin e prokurimit elektronik te prezantuara nga OE ankues, pothuaj të gjitha kontratat e objekteve sportive te prezantuara kanë pozicione të ndërtimit të tribunave, po ashtu vlen te theksohet se edhe OE i propozuar për kontratë nga AK në mënyrë të njëjtë i ka te specifikuara pozicionet e tribunave në kontratën e prezantuar). Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor i është i bazuar.

Paneli shqyrtues fillimisht nuk pajtohet me këtë konstatim të ekspertit shqyrtues për shkak se vlerësimi i tij është shumë subjektiv dhe për më tepër i thirrur edhe në opinionin e KRPP, opinion i cili është më i gjerë dhe jo vetëm kaq dhe pikërisht sipas këtij opinioni nr. 11 të publikuar nga KRPP në platformën e e-prokurimit me dt. 09.06.2023 ndër tjerash citon: "*Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik*". Po ashtu, këtë konstatim të ekspertit shqyrtues e ka atakuar edhe autoriteti kontraktues në deklarimin e tyre ndaj kësaj ekspertize, andaj, paneli shqyrtues duke u nisur nga interpretimi i lartcekur i KRPP, atëherë vendos që ta lë në diskrecion të AK dhe ta mbështet AK se kërkesat e DT ka qenë si kërkesë projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna, në rastin konkret ky GOE ka prezantuar disa referenca/procesverbale për

rregullimin e fushave sportive e terreneve sportive, mirëpo nuk ka prezantuar asnjë referencë që ka kryer stadium ose ndonjë Sallë Sportive që përfshijnë tribuna, ashtu siç ka qenë kërkesa në DT. Rrjedhimisht Panelit Shqyrtues duke e parë shumë të vështirë edhe përcaktimin e ngjashmërisë së kontratave për këtë aktivitet të prokurimit dhe secili vlerësim mund të jetë edhe subjektiv (ndryshe mendon autoriteti kontraktues, ndryshe operatori ekonomik, ndryshe paneli shqyrtues), atëherë vendos që ti mbetet në diskrecion dhe në përgjegjësi AK (zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave) vlerësimi i përmbushjes së kritereve të DT, konform nenit 59.1 të LPP.

Ankuesi atakon vendimin e AK lidhur me eliminim e tij/saj ku sipas AK, operatori ekonomik në këtë rast ankuesi nuk ka prezantuar ISO Standarde për te gjithë anëtaret e grupit , Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me l)jë numër të eaktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare. evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatës. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar sipas LPP neni 69, paragrafi 8 e përcakton se një grup i OE për kërkesat sipas këtij neni, mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjektet tjera. Gjithashtu sipas RrPP 001/2022, neni 26.5 e përcakton se çdo kërkesë e vendosur nga AK sipas nenit 66.2, nenit 68 dhe nenit 69 të LPP-së aftësia teknike dhe profesionale do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Pra çdo kërkesë e AK e vendosur tek Kërkesat Teknike dhe Profesionale ne FDT, neni 9.1 & 9.2, do tëaplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi e jo ndaj anëtarëve individual të grupit, kështu që mjafton njëri nga anëtarët e grupit të plotësoj kërkesën e DT. Eksperti konsideron se kërkesa e DT është plotësuar nga OE ankues, pasi që njëri nga anëtarët pjesëmarrës të grupit ka dorëzuar dokumentet e kërkuara. AK në këtë rast ka bërë shkelje, duke vlerësuar se të gjithë anëtarët e grupit individualisht duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura ne 9.1&9.2 te DT, sipas nenit 69 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nuk e mbështet këtë konstatim të ekspertit shqyrtues i cili nuk ka marrë parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, shkresat e AK (arsyet e eliminimit), vendimin e AK në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, pastaj dispozitën nr. 26.6 të RrPP Nr. 001/2022, si dhe interpretimit e KRPP Nr. 29 të publikuar në platformën e e-prokurimit me dt. 22.06.2023 ndër tjerash citon: "*Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse*". Pasi që, Kërkesa e DT dhe njoftimit për kontratë është "Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me - ISO 9001-2015 - ISO 14001-2015 - ISO 31000-2018 - ISO 39001-2012 - ISO 45001-2018", për Paneli Shqyrtues është fakt notor se kjo kërkesë ka të bëjë me operatorin ekonomik e jo me produktin e ashtu sikurse e ka përshkruar eksperti shqyrtues. Andaj, në konsistencë edhe me vendimet tjera të OSHP për raste të ngjashme

edhe në këtë rast Paneli Shqyrtues e mbështet AK në deklaratën e tyre ndaj këtij konstatimi të ekspertit, duke deklaruar se: "*Për AK ky konstatim është i pabazuar edhe për faktin që GOE ka formuar marrëveshje me anëtarë tjerë për kryerjen e punimeve duke ndarë përgjegjësit, dhe ne në DT kemi kërkuar që ofertuesi duhet të jetë I certifikuar me disa ISO standarde. Në rastin konkret nëse nuk kane të prezantuar të gjithë anëtaret e grupit standardet, I bie që disa punime që janë përgjegjësi e anëtareve të pa standardizuar do të kryhen në mënyrë jo cilësore dhe nga kompani që nuk është e standardizuar më standardet e kërkuar. Andaj konsiderojmë që më të drejtë është eliminuar pasi që anëtarët e grupit të cilët nuk janë të standardizuar me ISO të kërkuar rrezikojnë cilësinë dhe profesionalizimin e punimeve që do të kryhen në këtë projekt, pasi që projekti është një konstruksion komplet nga Metali, kërkon një kompani profesionale, që kanë përvojë në punime të tilla dhe që janë të standardizuara për ato punime*". Kështu që, ky pretendimi ankimor është i pabazuar.

Duke u nisur nga fakti se këto pretendime ankimore kualifikohen të pa bazuara nga ana e këtij Paneli Shqyrtues duke u bazuar në prova, shkresa dhe dokumente relevante të kësaj procedure, si dhe dispozita ligjore të mbështetura me interpretime dhe opinione të KRPP, atëherë, konsideron se operatori ekonomik ankues është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe me të drejtë është eliminuar nga kjo procedurë e prokurimit nga ana e AK.

Pohimet ankimore te Ankuesit NPN "EUROING" SH.P.K

Ankuesi atakon vendimin e AK lidhur me eliminim e tij/saj ku sipas AK, operatori ekonomik në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar dëshmi se në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme në vlerë minimum 550.000.00 Euro (projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna),ju si Operator Ekonomik nuk keni paraqitur asnjë objekt sportiv. stadiume apo salla sportive te cilat përfshinë tribuna. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues sipas opinionit të dhënë nga KRPP termi "e ngjashme" nuk do të thotë se natyra e kontratës të jetë identike apo e njëjtë me përshkrimin e objekteve të dhëna në DT. Kontrata të ngjashme sipas përshkrimit të termit "ngjashme" të dhënë sipas opinionit të KRPP mjafton të jetë projekt objekt ndërtimor sportiv, ku mund të përfshihen edhe kategorizimi i kontratave të objekteve të ndërtimit të lartë. OE ankues ka ofruar listën e kontratave të ngjashme të dëshmuara sipas kërkesës së DT dhe ka arritur vlerën e kërkuar nga AK në DT (shënim: pas verifikimit te kontratave ne sistemin e prokurimit elektronik te prezantuara nga OE ankues, pothuaj të gjitha kontratat e objekteve sportive te prezantuara kanë pozicione të ndërtimit të tribunave. OE ankues ka ofruar listën e kontratave të ngjashme të dëshmuara sipas kërkesës së DT, ndër të tjera ka ofruar 3 kontrata të sallave të edukatës fizike që mund të konsiderohen objekte sportive, duke arritur vlerën e kërkuar nga AK në DT dhe për më tepër, nëse AK ka pasur dilema në vërtetësinë apo validitetin e dokumenteve të ndonjë kontrate apo reference, është dashur të kërkojë sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues fillimisht nuk pajtohet me këtë konstatim të ekspertit shqyrtues për shkak se vlerësimi i tij është shumë subjektiv dhe për më tepër i thirrur edhe në opinionin e KRPP, opinion i cili është më i gjerë dhe jo vetëm kaq dhe pikërisht sipas këtij opinioni nr. 11 të publikuar nga KRPP në platformën e e-prokurimit me dt. 09.06.2023 ndër tjerash citon: "Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një përcaktim i tillë

është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik". Po ashtu, këtë konstatim të ekspertit shqyrtues e ka atakuar edhe autoriteti kontraktues në deklarimin e tyre ndaj kësaj ekspertize, andaj, paneli shqyrtues duke u nisur nga interpretimi i lartcekur i KRPP, atëherë vendos që ta lë në diskrecion të AK dhe ta mbështet AK se kërkesat e DT ka qenë si kërkesë projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të objekteve sportive, stadiumeve apo sallave sportive që përfshijnë tribuna, në rastin konkret ne mirëkuptojmë arsyetimin e ekspertit shqyrtues që ndonjë punë e kryer nga ky GOE është e ngjashme, mirëpo bazuar në LPP-në kërkesa në DT duhet të përfillen për të gjithë OE, dhe nuk kem drejtë pas hapjes së ofertave të mos i zbatojmë kërkesat e vendosura në DT apo të zbatojmë kritere tjera ashtu siç konstaton eksperti shqyrtues duke pasur parasysh që kërkesa ka qenë e qartë të dëshmohen referenca të objekteve sportive dhe stadiume ose salla sportive me tribuna, dhe në rast të paqartësive kane mundur OE në kohen e sqarimeve të kërkohen sqarime. Rrjedhimisht Panelit Shqyrtues duke e parë shumë të vështirë edhe përcaktimin e ngjashmërisë së kontratave për këtë aktivitet të prokurimit dhe secili vlerësim mund të jetë edhe subjektiv (ndryshe mendon autoriteti kontraktues, ndryshe operatori ekonomik, ndryshe paneli shqyrtues), atëherë vendos që ti mbetet në diskrecion dhe në përgjegjësi AK (zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave) vlerësimi i përmbushjes së kritereve të DT, konform nenit 59.1 të LPP.

Paneli shqyrtues lidhur me dy pretendimet tjera të ankuesit lidhur me qasjen në dokumentet zyrtare si dhe çmime jo sipas tregut vërteton konstatim e eksperti shqyrtues se të njëjtat nuk janë paraqitur në kërkesën për ri-shqyrtim, dhe Paneli Shqyrtues në konsistencë edhe me vendimet tjera vendos konform dispozita ligjore që mos të lëshohet në vlerësim të pretendimet ankimore të cilat nuk janë parashtruar me kohë gjatë fazës paraprake sipas autorizimeve të ligjvënësit ne kuptim të nenin 108/A dhe 109 të LPP-së lidhur me nenin 64.2 të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, nga OE ankues dhe të njëjtat nuk kanë qenë objekt shqyrtimi pranë OSHP, paneli sqaron se bazuar në nenin 24 të LPP "autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj". Po ashtu, AK është pajtuar me konstatimet e ekspertit për këto dy pika duke ofruar edhe sqarime të mëtutjeshme, në deklaratën e tyre ndaj raportit të ekspertizës Nr. 2023/0009.

Andaj, Paneli Shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës", atëherë në zabim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit edhe më tutje.Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

- Përfundim-

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues i cili kanë paqartësi me kërkesat dhe me specifikat e kërkuara DT, do duhej që në fazën paraprake, ti kundërshtoj të njëjtat apo eventualisht të parashtrojë pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK.

Në këtë kontekst edhe sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast, pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë. Kjo siguron që procedurat e prokurimit të mbeten efikase dhe të përmbushin qëllimin e tyre të sigurimit të kontratave publike në mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjithë palët e interesuara. Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit.

Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik përderisa po ky aktivitet i prokurimit i është nënshtruar dy here procesit të rivlerësimit. Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Paneli shqyrtues, vendos që të lejoj kthimin e mjeteve (tarifës së ankesës) për shkak se paneli ka vendosur që pretendimin ankimor lidhur me kontratat e ngjashme në këtë rast sikurse interpretimi i KRPP që ta lë në diskrecion të AK, përshkak vështirësisë së përcaktueshmërisë rreth kualifikimit të ngjajshmërisë së kontratave të realizuara.

Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifës

ankimore, përfshirë dhe operatorët ekonomik të cilët janë provuar nga qasja në dokumente. Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- OE - **Pro & Co Group SH.P.K., NPN EUROING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: